

STATUTI I SHOQËRISË dhe AKT THEMELIMI
"FLY REIMBURSE SHPK"

Sot me date 29.05.2024, ne perputhje me:

- Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare";
- Ligjin nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"

Znj.Oksana Datja, shtetase Shqiptare, e lindur me 04.12.1991 ne Berat dhe banues ne Tirane, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e kartes se ID me nr. J16204051W themelon ne cilesine e Ortakut te Vetem, Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "FLY REIMBURSE" SHPK me permbajtjen si me poshte vijon:

KAPITULLI I

FORMA, KOHEZGJATJA, ZYRA QENDRORE, OBJEKTI

Neni 1: Forma Juridike

Shoqeria "FLY REIMBURSE" SHPK eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"), e themeluar nga personi fizik i siperpermendur, i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkuara.

Neni 2: Kohezgjatja

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.



Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pakufizuar që fillon prej dates së regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit (me poshtë referuar si QKR).

Në përputhje me këtë statut, shoqëria mund të pezullojë ose mbyllë veprimtarinë e saj kur e shih të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

Neni 3: Zyra Qendrore

Zyra Qendrore e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Njesia Bashkiake nr 5, Bulevardi Bajram Curri, Pallati nr 25, Dytani nr 5, Tirane.**

Gjate ushtrimit të aktivitetit të saj, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.


Neni 4: Objekti

Shoqëria do të ketë për objekt kryesor të veprimtarisë së saj:

- a) Do të shërbejë si agjensi për rezervimin dhe blerjen e biletave të udhetimeve, si edhe të paketave turistike etj.
- b) Shoqëria ofron ndaj palëve të treta shërbime të konsulencës, asistencës, studimit, ekspertizës, përfaqësimit, ndërmjetësimit, trajnimit, dhe mbrojtjes ligjore, në fushën e zbatimit të Rregullores Evropiane EC261/2004 si dhe Ligjit nr. 96/2020 Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dalë në zbatim të tij, për të drejtat e pasagjerëve dhe në shtete të tjera në rastet e vonësive, anulimeve dhe mohimit të imbarkimit në fluturime etj.

-Gjithashtu, për të realizuar objektivat e saj, shoqëria mund të ndermarre e të zhvillojë edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që siguron të ardhura dhe fitime të ligjshme.

- Objekti i shoqërisë mund të zgjerohet apo zvogëlohet në varesi të interesave të shoqërisë dhe në bazë të vendimit të asamblese së përgjithshme të ortakeve.



KAPITULLI II

KAPITALI

Neni 5: Kapitali themeltar

5.1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (nje qind mije) lekë i formuar ne mase te plote nga kontributi i ortakut dhe i ndare ne nje kuote me vlere nominale sipas ndarjes se meposhtme. Cdo kuote njesie ka te drejten e nje vote. Pjesmarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tij si me poshte:

Ortaku themelues, Oksana Datja, zoteruese e nje kuote me vlere te pergjithshme 100.000 (nje qind mije) leke, qe perben 100% te kapitalit themltar te shoqerise.

KAPITULLI III

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 6: Organet kryesore drejtuese te shoqerise

Organet kryesore drejtuese te shoqerise jane:

- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve
- Administratori

Neni 7: Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

Te drejttat dhe detyrimet




7.1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

7.2. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike.
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) cheshtje te tjera te parashikuara nga ligji

7.3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së pergjithshme ushtrohen nga ortaku i vetem. Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem regjistrohen ne një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:



- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 8: Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme të Ortakeve


8.1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë drejtuar ortakeve të shoqërisë. Njoftimi me shkresë duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

8.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 10.1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 9: Kuorumi

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

b) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht dhe votojnë me shkresë.



c) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 10: Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 11: Administrimi



11.1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, të cilët duhet të jenë detyrimisht ortake të saj. Afati i emërimit të administratorit është 2 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit

11.2. Administrator i parë i shoqërisë është Znj. Oksana Datja e cila zgjidhet për një periudhë 2 vjeçare.

11.3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Neni 12: Kompetencat e administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Neni 13: Mosmarreveshjet



Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor nen juridiksinin e se cilit shtrihet aktiviteti i shoqerise.

Neni 14: Largimi i ortakut

Ky statut nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun ne baze te dispozitave perkatese te legjislacionit tregtar ne fuqi.


Neni 15: Dispozita perfundimtare

Ne cdo rast, palet do ti referohen dispozitave ligjore te ligjit 9901, date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" per zgjidhjen e ceshtjeve konkrete dhe te detajuara te cilat nuk jane permendur specifikisht ne kete akt themelimi personi juridik.

Ky statut u redaktua ne 3 ekzemlare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi u miratua ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i Vetem i Shoqerise, u nenshkrua rregullisht nga ai pa asnje verejtje.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Oksana Datja

A handwritten signature in black ink, reading "Oksana Datja". The signature is written in a cursive style with large, flowing letters. Below the main signature, there is a smaller, more compact handwritten mark that appears to be a stylized initial or a second signature.